



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJET E BASHKUARA**

**Nr. 31001-00019-00-2015 i Regj. Themeltar  
Nr. 00 – 2022 – i Vendimit**

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol SADUSHI</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Artur KALAJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir PANDA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Albana BOKSI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Medi BICI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sokol BINAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sandër SIMONI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ervin PUPE</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Asim VOKSHI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Arbena AHMETI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Gentian MEDJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sokol NGRESI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dariel SINA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enton DHIMITRI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Margarita BUHALI</b>	<b>Anëtare</b>

në datën 18/11/2022 morën në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. 31001-00019-00-2015, që i përket:

**PADITËS:** Agjensia Shtetërore e Kadastrës

**I PADITUR:**  
1. Ylli Zeqiri;  
2. Bashkia Sukth.

**OBJEKTI:**  
1. Deklarimin e pavlefshmërisë ligjore të aktit të marrjes së tokës në pronë, AMTP nr. 402, datë 30.04.1996 në emër të shtetasit Ylli Zeqiri;  
2. Shfuqizimin e tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 32 i Kodit të Procedurës Civile; Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, neni 9 e vijues i tij; Neni 116 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative.

## KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarit **Sokol Sadushi** dhe diskutuan çështjen në tërësi,

### VËREJNË:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala e paditur, z. Ylli Zeqiri është pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, nr. 402, datë 30.04.1996 (në vijim AMTP), nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Hamallaj, Bashkia Sukth, për një sipërfaqe prej 15.000 m<sup>2</sup>, tokë të cilën e posedon edhe aktualisht.

2. Rezulton se me vendimin nr. 157, datë 25.02.2010, Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, i ngritur pranë Prefektit të Qarkut Durrës, ka marrë në shqyrtim kërkesën e ankuesit, pranë familjes Qorralliu, e cila pretendon se prona që e trashëgon në mënyrë të ligjshme, i është ndarë në kundërshtim me ligjin të paditurit Ylli Zeqiri.

3. Sipas të dhënave të konstatuar nga Komisioni i Verifikimit të Vlefshmërisë ligjore të Titujve të Pronësisë për këtë zonë (në vijim Komisioni), rezulton se i padituri Ylli Zeqiri, është pajisur me AMTP, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” (në vijim Ligji nr. 7501). Po ashtu, Komisioni ka konkluduar se AMTP vjen në kundërshtim edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore” (në vijim VKM nr. 452), pika 2 dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi dhe pa shpërblim të tokës bujqësore” (në vijim Ligji nr. 8053).

4. Në kohën e ndarjes së tokës bujqësore, sipas Ligjit nr. 7501, referuar gjendjes familjare me datë 01.08.1991, kohë në të cilën ka hyrë në fuqi ky ligj, i padituri Ylli Zeqiri, nuk ka qënë anëtar i familjes bujqësore, pasi nuk ka qënë banor i fshatit Hamallaj. Po ashtu, rezulton se pala e paditur nuk ka qënë punonjës i Ndërmarrjes Bujqësore Sukth dhe për rrjedhojë nuk ka qënë subjekt përfitues sipas VKM nr. 452 dhe sipas Ligjit nr. 8053.

5. Nga provat e administruara në gjykim, nuk rezulton që procesi i ndarjes së tokës në ish-Ndërmarrjen Bujqësore Sukth, të jetë bërë në përputhje me kriteret e VKM nr. 452 dhe Ligjit nr. 8053. Së fundi, rezulton se parcela që i përket pronës së palës së paditur, Ylli Zeqiri, shtrihet brenda vijës kufizuese të zonës me përparësi zhvillimin e turizimit, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 321, datë 20.07.1992 dhe VKM nr. 88, datë 01.03.1993.

**6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. (11-2012-1707) 583, datë 28.02.2012, ka vendosur:**

*“1. Pranimin e kërkesëpadsisë së paditësit Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, Prefektura e Qarkut Durrës;*

*2. Deklarimin e pavlefshmërisë ligjore të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 402, datë 30.04.1996 në emër të të paditurit Ylli Zeqiri;*

*3. Shfuqizimin e këtij akti dhe kthimin e pronës në emër të pronarit “shtet”.*

7. Kundër vendimit nr. 11-2012-1707) 583, datë 28.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me datë 07.03.2012 ka ushtruar ankim pala e paditur, z. Ylli Zeqiri, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

8. Gjykata e Apelit Durrës ka shpallur moskompetencën lëndore dhe i ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Apelit, si gjykata kompetente.

9. **Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 966, datë 21.03.2014** ka vendosur:

*“Prishjen e vendimit nr. 583 (1707), datë 28.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.”*

10. Në marrjen e këtij vendimi, Gjykata ka arsyetuar se në gjykim duhet të thirreshin të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, akti i marrjes në pronësi, të cilëve ka qënë objekt gjykimi. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, këtyre të fundit u është mohuar e drejta për tu thirrur dhe dëgjuar në gjykim. Në këto rrethana, Gjykata Administrative e Apelit ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë për mosformim të rregullt të ndërgjyqësisë.

11. **Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit** ka ushtruar rekurs pala paditëse, Komisioni, më datë 31.07.2014, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në rekurs është parashtruar se:

- *Bashkëpronësia në familjen bujqësore, referuar dispozitave të Kodit të Familjes është një nga llojet e bashkëpronësisë në tërësi dhe në këtë lloj bashkëpronësie përfaqësimi bëhet nga kryetari i saj;*
- *Gjykata nuk ka hetuar nëse toka bujqësore mund të ishte pjesëtuar ndërmjet anëtarëve të familjes së saj ose nëse ishin zgjedhur persona të tjerë si kryetarë të familjes bujqësore. Për rrjedhojë nuk mund të arrinte në konkluzionin që ka arritur;*
- *Gjykata Administrative e Apelit në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrim të ndryshëm, duke mos e konsideruar si mosformim të rregullt të ndërgjyqësisë faktin se mosthirrjes në gjykim të të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore dhe duke mos cenuar për rrjedhojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë.*
- *Nëse në gjykim do të legjitimoheshin të gjithë anëtarët e familjes bujqësore atëherë në nënshkrimin e AMTP, duhet të merrnin pjesë të gjithë anëtarët e familjes bujqësore dhe si rrjedhojë ky akt është i pavlefshëm edhe për këtë shkak. Por në të kundërt sa pretendon gjykata, familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari në raport me të tretët.*

12. **Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), (i përbërë prej 5 gjyqtarë), në seancën gjyqësore, datë 13/06/2017**, nisur nga fakti se ka patur praktika të ndryshme gjyqësore në lidhje me formimin e rregullt të ndërgjyqësisë në paditë me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga Komisionet e Verifikimit të Titujve të pranë Prefektit të Qarkut, ka vlerësuar kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke shtruar këto çështje për zgjidhje:

a) *Në paditë me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga Komisionet e Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut, duhet të thirren me cilësinë e të paditurit të gjithë anëtarët e familjes bujqësore apo mjafton të thirret vetëm kryetari si përfaqësues i saj?*

b) *Për efekt të ndërtimit të rregullt të ndërgjyqësisë, nëse në gjykim do të thirren me cilësinë e të paditurit të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, do të konsiderohen si të tillë vetëm personat që figurojnë në certifikatën familjare, përkatësisht të datës 01.08.1991, për ish-kooperativat bujqësore dhe 01.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore, apo edhe persona të tjerë sipas kriterëve të nenit 223 të Kodit Civil (personat që lidhen ndërmjet tyre, për shkak gjinie, martesë, birësimi, ose pranimit si anëtar i familjes bujqësore)?*

c) *Deri në çfarë raportesh juridike shtrihet e drejta e kryetarit të Familjes bujqësore për të përfaqësuar këtë të fundit në marrëdhënie pasurore me të tretët?*

## II. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

13. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegjet), sjellin në vëmendje disa ndryshime thelbësore që kanë pësuar dispozitat kushtetuese dhe legjislacioni procedural, penal, civil dhe administrativ, mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së lartë, në veçanti në lidhje me kompetencën thelbësore të saj mbi njësimin, ndryshimin apo zhvillimin e praktikës gjyqësore.

14. Paragrafi i dytë i pandryshuar i nenit 141 të Kushtetutës parashikonte se:

*“2. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.”*

15. Nga kjo normë kushtetuese kuptohej se unifikimin e praktikës gjyqësore dhe ndryshimin e saj kishte autoritet ta bënte vetëm trupa gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për krijimin e precedentëve fillestar si dhe për ndryshimin apo zhvillimin e tyre në të ardhmen.

16. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të cilat hynë në fuqi në datë 11.08.2016, neni 141 i Kushtetutës parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. 2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.”*

17. Kjo do të thotë se, ndryshe nga më parë, funksionin e nomofilatisë apo uniformitetit të praktikës gjyqësore mund ta realizojë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për çështjet civile, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për çështjet administrative dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për çështjet penale. Këtë funksion kushtetues dhe ligjor secili prej kolegjeve do ta realizojë nëpërmjet vendimeve njësuere.

18. Ndërkohë një çështje do të kalojë për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në rastet kur vendimet njësuere vlerësohen nga secili prej kolegjeve apo nga Kryetari i Gjykatës së Lartë se kanë nevojë të ndryshohen, duke ndryshuar praktikën gjyqësore për një çështje apo disa të tilla të njësuara më parë nga kolegji respektiv. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 141 pika 2 të ndryshuar të Kushtetutës, do të gjykojnë edhe çështjet në të cilat secili prej kolegjeve apo Kryetari i Gjykatës së Lartë kërkojnë të ndryshojnë vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të dhëna më parë ndryshimeve kushtetuese, duke qenë se sot ato janë analoget e vendimeve njësuere të praktikës gjyqësore. Pikërisht ky është ndryshimi substancial kushtetues në mënyrën se si do të njësojë, ndryshojë apo zhvillojë praktikën gjyqësore Gjykata e Lartë nëpërmjet secilit kolegji apo Kolegjeve të Bashkuara.

19. Për të konkretizuar dhe zbatuar në ligj parashikimet e reja të nenit 141 të Kushtetutës, Ligji nr. 98/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, në nenin 32 normoi rastet e kompetencës funksionale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke parashikuar se:

*“1. Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore.*

*2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjet kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar sipas rregullave të caktuara në legjislacionin procedural civil, penal dhe administrativ në fuqi.”*

20. Ndryshimet e ligjeve procedurale gjyqësore në vitin 2017 dhe 2021, referuar ndryshimit të Kushtetutës, plotësuan dhe detajuan kuadrin ligjor të nevojshëm për të ushtruar Gjykata e Lartë juridiksionin ekskluzivisht ligjor dhe rishikues dhe njëkohësisht edhe nomofilatik. Ndryshimet ligjore që iu bënë nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 58 të Ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale kishin si qëllim zbatimin e drejtpërdrejtë të nenit 141. Duke uniformizuar në të tre ligjet procedurale shkaqet e rekursit, si një mjet i zakonshëm i ankimit që

aktivizon juridiksionin rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, sigurohet ushtrimi kushtetues i juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

21. Kolegjet sjellin në vëmendje parashikimin e nenit 12/3 të Ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 49/2021, pas ndryshimeve kushtetuese të analizuara më sipër. Kjo dispozitë ka parashikuar se:

*“...Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.”*

22. Edhe neni 35/3 i KPC, i ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, ka parashikuar se:

*“Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve, çështjet e parashikuara shprehimisht në dispozita të tjera të këtij Kodi.”*

23. Në përmbyllje të analizës kushtetuese dhe ligjore mbi vendimet e posaçme nomofilatike apo vendimet njësuere të Gjykatës së Lartë, konkludohet se, ndryshe nga sa parashikohej më parë në Kushtetutë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë do të jenë kompetent për të vendosur për të ndryshuar praktikën gjyqësore, të njësuar më parë nga Kolegji Civil, Administrativ apo Penal, për të ndryshuar vendimet unifikuese të dhëna më parë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë apo për të ndryshuar vendimet që do të jepen në të ardhmen nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ky kuadër kushtetues dhe ligjor kuptohet se njësimi i praktikës gjyqësore pas ndryshimeve kushtetuese është në kompetencën e Kolegjit Penal për çështjet penale, Kolegji Civil për çështje civile dhe Kolegjit Administrativ për çështje administrative.

24. Me njësim të praktikës gjyqësore do të thotë unifikimi i qëndrimeve të ndryshme të praktikës gjyqësore të gjykatave më të ulëta apo unifikimi i qëndrimit të kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë të mbajtura në vendimet e zakonshme të tyre mbi zbatimin e një apo disa normave ligjore dhe se kjo kompetencë nomofilatike i është njohur nga Kushtetuta dhe ligjet procedurale secilit kolegje të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar se krijimi i precedentit të parë apo krijimi i precedentit fillestar mbi një çështje civile, penale apo administrative nga ana e Gjykatës së Lartë do të bëhet nga secili kolegje respektiv, duke vendosur njësimin e praktikës gjyqësore të ndryshme të mbajtur më parë nga gjykatat.

25. Së fundi, Kolegjet sjellin në vëmendje ndryshimet që kanë pësuar ligjet procedurale mbi gjykimin në Gjykatën e Lartë, në maj të vitit 2021. Konkretisht në dispozitën kalimtare të parashikuar në KPC me ligjin nr. 44/2021 është parashikuar se:

*“1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.*

*2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.”*

26. I njëjti parashikim ligjor, në titullin “Dispozitë kalimtare”, u shtua me Ligjin nr. 49/2021, në Ligjin nr. 49/2012.

27. Në vijim të kësaj analize, në çështjen konkrete, Kolegjet vlerësojnë se vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, datë 13.06.2017, në pjesën që ka vendosur kalimin e çështjes për unifikimin e praktikës gjyqësore në Kolegje të Bashkuara, ka humbur aktualitetin ligjor dhe kushtetues. Tashmë një kompetencë e tillë funksionale i përket Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku vendimi njësuar i Kolegjit është analog i vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, para ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese të analizuara më sipër. Si rrjedhojë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet t’ia kalojnë

këtë çështje për njësimin e praktikës gjyqësore, për çështjet e parashtruara më sipër, Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe në nenin 62/a të Ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të shtuar me Ligjin nr. 49/2021,

**V E N D O S I:**

Kalimin e çështjes nr. 31001-00019-00-2015, për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, për njësimin e praktikës gjyqësore.

**Tiranë, më 18.11.2022**